

# STATUTI dhe AKT THEMELIMI I SHOQERISE

## Erina Media Group SHPK

Mbeshtetur ne Kushteturen dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit". ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" dhe ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", me vullnetin tim te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij aktthemelimi dhe statuti te shoqerise

### KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

#### Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot me 28/07/2022, une, themeluesi Renato Hyselli, i biri i Fetiut-it, lindur 24.05.1991 ne Buzhqen Devoll, dhe banues ne Tirane, i pajisur me nr personal J10524067N kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Erina Media Group" SH.P.K. Shoqeria gezon statusin e personit juridik (biznes i vogel, pa TVSH).

#### Neni 2: Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtern:

Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet te lejuar me ligj ne Republiken e Shqiperise, duke perfshire por pa u kufizuar ne: Sherbim fotografie, video, editim, sherbime telemarketingu ose marketingu online etj, ne te gjitha fushat e mesiperne por duke mos u limituar ne to.

#### Neni 3: Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise dote jete e pacaktuar.

#### Neni 4: Selia

- (I) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen Rruga Albanopoli Zona Kadastrale 8330 Nr Pasurie 9/842+2-9 Shkalla 2 Ap 9, Tirane.

### KREU II KAPITALI

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

(I) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 1,000 Leke (njemije).

Pjesemarria e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte e perputhje me kontributet e tyre te meposhterne:

**Ortaku themelues Renato Hyselli:** Zoterues e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise te barabarte me 1,000 leke.

Kapitali per momentin eshte i pa ndare.

Kapitali te shtohet ose te pakesohet ne perputhje me ligjet Shqiptare.

Kontributi i ortakeve do te jete ne para.

#### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnie rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### **Neni7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise,
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetern vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percakrirnin e shperblimeve per personae e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;

dh) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgarëjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti,

Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë dhe përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asambletë dhe përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese mëtej në të njëjtën ditë.

## **Neni 9**

### **Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrime ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkrime apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditëve të t'u dërgohet të gjithë ortakeve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, përveçse për rregullat.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Në rastin e manjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse orakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrime, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, më tej në të njëjtën ditë.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos më të paktën tre të katërtat e votave të zotëruara të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos më shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;

c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;

ç) përcaktimin e shpërblimeve

- d) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykata dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
- Cdo ndryshim i statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

I. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhenien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## **Neni 13**

### **Administrimi**

(I) Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emerimit, është 5 vjet, me të drejtë riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

(II) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratore të parë të shoqërisë deri në emerimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblese së Përgjithshme.

Te dhenat e identifikimit: Renato Hyselli, lindur më 24.05.1991 në Buzhqen/Devoll, me nr personal identifikimi J10524067N.

## **Neni 14**

### **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitirneve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhenat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të theksin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshmë brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Nëse asambleja e përgjithshme emëron me shurmë se një administrator, atë e administrojnë bashkërisht shoqëria.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Padite, që lidhen me shprehimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqëria, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësi e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç: sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- I. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në teresi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezent apo të rëndësishme, të interesave personale me atë të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave I dhe 2 të këtij neni, është i detyruar t'i demshpërblejë shoqërisë demet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që atë apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga keto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, atë përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në të, administratori është i detyruar t'i demshpërblejë shoqërisë demet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesat apo dividendet;

- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshrne. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## **KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTET**

### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe rmbillet me 31 Dhjetor.

### **Neni 17 Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

## **KREU V PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

### **Neni 18 Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kornbetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19****Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

**Neni 20****Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21****Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatirnin apo interpretirnin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE  
Erina Media Group SHPK

Renato Hyselli

Tirane Korrik 2022